ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**

(Shëno emrin e Autoritetit Kontraktues)

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **622-24-4093-2-1-1**

(Shëno numrin e Aktivitetit të Prokurimit)

Sa i përket tenderit për **Digjitalizimi i sistemit të institucioneve arsimore në shkollat e Komunës së Prizrenit**

(Shëno titullin e kontratës si në Dosjen e Tenderit)

ANKESË

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

N.T.SH. "UNISOFT"

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. "Raif Pollomi", L1/2, Nr. 6

(Adresa)

Prishtinë, Kosovë — *10000*

(Vendi) — *(Kodi postar)*

+383 44 250 052

(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

Arianit Bytyqi

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@unisoft-rks.com

(Adresa elektronike)

14.06.2024

(Data e parashtrimit të kërkesës)

N.T.SH. UNISOFT PRISHTINË

(Nënshkrimi dhe vula)

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.
Shëno të dhënat si në vijim:

_____
(Emri i avokatit)

_____
(Adresa e plotë)

_____ _____
(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____
(Adresa elektronike)

_____ _____
(Data e parashtrimit të kërkesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Lloji i dokumentit	Data e publikuar
B05 Njoftim per Kontrat	29.04.2024
Kerkesa per Rishqyrtim	07.06.2024
Vendimi i AK per Rishqyrtim	07.06.2024

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☐

Kërkesa për Rishqyrtim dorëzohet tek AK- MPB, sipas RROUP dhe LPP

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [X] **Jo** [ ]

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues ka proceduar në kundërshtim me:
- **Neni 1 – paragrafi 1**
- **Neni 7 – paragrafi 1,2,3,4,5,6**
- **Neni 51 – paragrafi 1**

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Neni 1 – paragrafi 1, 3 - Ligjit Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092
Neni 1 - Qëllimi

1. Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.
3. Ky ligj ka për qëllim të nxisë krijimin e një kulture institucionale të profesionalizuar të pandikuar nga interesat materiale, të paanshme, etike, në mesin e personave zyrtarë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit, duke kërkuar nga personat e tillë që të sjellen duke ndjekur parimin e shfrytëzimit sa më efikas, me kosto ekonomike, transparent dhe të drejtë të fondeve dhe burimeve publike ndërkaq duke iu përmbajtur rreptësisht procedurave dhe kushteve qenësore të këtij ligji.

Deklarata, Faktet dhe argumentet:

Ne pretendojmë që kjo dispozitë e LPP është shkelur pasi AK- KK PRIZREN nuk ka

trajtuar në parim RROUP dhe LPP duke përfshi nenin 1.

Ne si OE NTSH UNISOFT në këtë procedurë të prokurimit diskriminohemi nga kriteret të cilat janë vendosur dhe të cilat një shumicë e tyre i diskriminon shumë OE dhe favorizon një OE. AK ka kryer shkelje duke vendosur kriteret diskriminuese në kundërshtim me nenit 1 të LPP.

Neni 7 - Ligjit Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092

Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

1. Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik.

3. Pa e cenuar paragrafin e mësipërm, autoritetit kontraktues posaçërisht i ndalohet që të përcaktojë nevojat e veta që duhet të përmbushen, specifikojë lëndën që do të prokurohet, ndajë ose përmbledh sasitë ose artikujt e tjerë që duhet të prokurohen, duke zgjedhur një procedurë të prokurimit, ose duke vendosur një kërkesë ose kriter të përzgjedhjes ose specifikacion teknik që në ndonjë mënyrë ka për qëllim të favorizojë ose diskriminojë kundër njërit ose më shumë operatorëve ekonomik.

4. Autoriteti kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik.

5. Autoriteti kontraktues nuk do të kërkojë nga operatori ekonomik që të (i) punësojë ose përdorë, ose të mos punësojë ose përdorë, ndonjë person ose ndërmarrje të veçantë për ekzekutimin e çfarëdo aspekti të një kontrate publike, ose (ii) që të furnizojë ose sigurojë, ose të mos furnizojë ose sigurojë, produkte ose shërbime të cilat rrjedhin nga një person, ndërmarrje ose rajon i veçantë gjeografik. Në rast se një kërkesë e tillë është veçanërisht e autorizuar nga ky ligj, ndonjë ligj tjetër ose marrëveshje ndërkombëtare, parametrat e saktë të një kërkese të tillë do të saktësohen në kontratë ose në njoftimin e konkursit të projektimit, ftesën për pjesëmarrje ose tenderim, dhe në dosjen e tenderit.

6. Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit; (ii) publikimin e rregullt, dërgimin dhe/ose disponueshmërinë e të gjitha njoftimeve, ftesave, informacioneve dhe dokumenteve që kanë të bëjnë me aktivitetin e prokurimit në përputhje me këtë ligj; (iii) eliminimin e praktikave, kritereve, kërkesave dhe specifikimeve teknike që diskriminojnë në favor ose kundër një ose më shumë operatorëve ekonomik; (iv) që të gjitha specifikimet teknike dhe të gjitha kërkesat për përzgjedhje dhe dhënie, duke përfshirë rëndësinë relative të secilës kërkesë dhe kriter të tillë, si dhe metodat e përzgjedhjes dhe dhënies të saktësohen në njoftimin e kontratës ose konkursit përkatës të projektimit, në ftesën për tender ose pjesëmarrje dhe/ose në dosjen e tenderit; (v) që asnjë kërkesë, kriter, specifikim që nuk është saktësuar kështu, të mos përdoret në procesin e përzgjedhjes ose dhënies, dhe (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse.

Deklarata, Faktet dhe argumentet:

Ne konsiderojmë që kjo dispozitë e LPP është shkelur pasi AK- KK PRIZREN nuk ka trajtuar ne parim RROUP dhe LLP sipas nenit 7.

AK- KK Prizren ka vendosur kritere diskriminuese.

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2

Kërkesa në Dosjen e Tenderit , Njoftimit për kontratë tek fleta e të dhenave të tenderit (FTD)

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2

Kapaciteti teknik dhe professional:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare*
Kërkes 1. Projektet e natyrës së kontratës realizuara ne tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit të standardeve dhe vlerat e tyre, vlera,minimale e të gjitha projekteve të natyrës së kontratës duhet të jetë jo më e vogël se 450.000,00 € • . Operatori Ekonomik duhet të ketë përvojë në zhvillimin dhe implementimin e të paktën 1 (një) projekti për institucionet arsimore si dhe platforma e zhvilluar të ketë aplikacion për IOS dhe Android OE duhet të dëshmoj se ka përvojë në zbatimin e së paku dy (2) sistemeve të raportimit, të paktën në një organizatë me mbi 100 përdorues.	Dëshmia 1.Një listë të projekteve të realizuara Origjinal e vulosur dhe e nënshkruar nga OE për projekte të përfunduara, lista duhet ti ketë këto te dhëna Titullin e kontratës, operatorin ekonomik, Datën e fillimit të kontratës, Datën e përfundimit të projektit, vlerën e projektit, Përshkrimin e projektit dhe detyrave, rolin e kompanisë ofertuese në zbatimin e kontratës (lider apo partner). Për çdo projekt qe është shënuar duhet referencat e lëshuara nga punëdhënësi. Një listë të kontratave te nënshkruar dhe vulosur, ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje te shërbimeve si dhe dëshmi të aplikacionit në IOS dhe Android nga APP store dhe Play store. Lista e projekteve (raport pranimi ose referencë nga autoriteti kontraktues apo kompanitë kontraktuese).
Kriteri diskriminues: Kerkesa: 1 - **dëshmi të aplikacionit në IOS dhe Android nga APP store dhe Play store** **Deklarata, Faktet dhe argumentet:** *Ne si NTSH UNISOFT konsiderojmë që vendosja e këtij kriteri është diskriminues dhe i panevojshëm, ky kriter na diskriminon ne si OE dhe favorizon një OE.* ***Ky kriter duhet të largohet nga FDT dosja e tenderit, njoftimi për kontratë***	

Kapaciteti teknik dhe professional: Kërkesa 5. Operatori Ekonomik duhet të dëshmoj se posedon ekspertë të kualifikuar me përgatitje shkollore dhe profesionale të personelit udhëheqës dhe në veçanti të personave që drejtpërdrejt janë përgjegjës për sigurimin e shërbimeve.	*Dëshmia e kërkuar dokumentare* Dëshmia 5 Listën e eksperteve qe do te angazhohen.
Kërkesa 5.a. Një (1) menaxher i projektit me përvojë pune në së paku dy (2) projekte që janë të ndërtuara në teknologji për web aplikacione me kompleksitete të mëdha si ne fushën e arsimit, financave apo te ngjashme; 2. Të jetë i diplomuar në shkenca kompjuterike ose inxhinieri softuerike; 3. Të jetë i certifikuar për Trajner të programit të trajnimit TIK, si p.sh ekspert për e-maturën. 4.Të ketë së paku 6 vite përvojë, dhe të ketë menaxhuar së paku 2 projekte në fushën e arsimit.	Dëshmia 5 a 1. Vendimin për cilësinë e angazhimit 2. CV e ekspertit e nënshkruar; 3. Letër-referencë nga punëdhënësi; 4. Kopja e noterizuar e diplomës universitare; 5. Kopja e noterizuar e certifikatës

Kriteri diskriminues: Kerkesa 5.a pika 3:

3. Të jetë i certifikuar për Trajner të programit të trajnimit TIK, si p.sh ekspert për e-maturën.

Deklarata, Faktet dhe argumentet:
Ne si NTSH UNISOFT konsiderojmë që vendosja e këtij kriteri tek menaxheri i projektit është diskriminues dhe i panevojshëm. Pasi që roli i Menaxherit të projektit është të menaxhoj projektin në aspektin profesional dhe teknik dhe nuk është e nevojshme certifikimi në pjesën e trajnimit në tik (e-matura) ky kriter na diskriminon ne si OE dhe favorizon një OE.

Ky kriter duhet të largohet nga FDT dosja e tenderit, njoftimi për kontratë

Kapaciteti teknik dhe professional: Kërkesa 5. Operatori Ekonomik duhet të dëshmoj se posedon ekspertë të kualifikuar me përgatitje shkollore dhe profesionale të personelit udhëheqës dhe në veçanti të personave që drejtpërdrejt janë përgjegjës për sigurimin e shërbimeve.	*Dëshmia e kërkuar dokumentare* Dëshmia 5 Listën e eksperteve qe do te angazhohen.
Kërkesa 5b. Një(1) menaxher teknik të projektit i cili duhet të jetë Inxhinier i Diplomuar ose Master i Shkencave Kompjuterike – minimumi tri (3) vite përvojë pune pas diplomimit dhe të jetë i certifikuar me ISO IEC 27001 Foundation si dhe të jetë i certifikuar në CCNA 1,2,3,4	Dëshmia 5b 1.Vendimin për cilësinë e angazhimit 2.CV e ekspertit e nënshkruar; 3.Letër-referencë nga punëdhënësi; 4.Kopja e noterizuar e diplomës universitare; 5.Kopja e noterizuar e certifikatës.

Kriteri diskriminues: Kerkesa 5.b pika 5:

- të jetë i certifikuar me ISO IEC 27001 Foundation si dhe të jetë i certifikuar në CCNA 1,2,3,4

Deklarata, Faktet dhe argumentet:
Ne si NTSH UNISOFT konsiderojmë që vendosja e këtij kriteri tek menaxheri i projektit është diskriminues dhe i panevojshëm. Pasi që roli i Menaxherit teknik është të menaxhoj projektin në aspektin profesional dhe teknik dhe nuk është e nevojshme certifikimi në pjesën e ISO IEC 27001 dhe CCNA 1,2,3,4 ky kriter na diskriminon ne si OE dhe favorizon një OE.

Ky kriter duhet të largohet nga FDT dosja e tenderit, njoftimi për kontratë

Kapaciteti teknik dhe professional:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare*
Kërkesa 6. Operatori ekonomik duhet të posedojë hapësirë – sallë totale minimumin 200 m2, me të gjitha pajisjet e nevojshme për mbajtjen e trajnimeve të stafit për ketë modul.	Dëshmia 6 OE, duhet të dëshmojë se posedon sallën për mbajtjen e trajnimeve në pronësinë e saj, ose marrëveshje për shfrytëzimin e sallës, me të gjitha pajisjet përcjellëse.

Kriteri diskriminues: Kerkesa 6

- **Salle trajnimi 200 m2**

Deklarata, Faktet dhe argumentet:
Ne si NTSH UNISOFT konsiderojmë që vendosja e këtij kriteri është diskriminues dhe i panevojshëm, ky kriter na diskriminon ne si OE dhe favorizon një OE.

Ky kriter duhet të largohet nga FDT dosja e tenderit, njoftimi për kontratë

Kapaciteti teknik dhe professional:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare*
Kërkesa 7 Operatori ekonomik duhet të paraqes dhe katalogun për pajisjet e ofruara. Kërkesa 8 Operatori ekonomik duhet të ketë platformën e gatshme, me kërkesat sipas Aneksi 1. Specifikimet teknike te detyrueshme, të Fazës së parë (1), në muajin e parë. OE duhet t'i shtojë platformës, në tre (3) muajt e parë veçoritë sipas Aneksi 1. Specifikimet teknike te detyrueshme, Faza e dytë (2). Pajisjet e nevojshme për platformë Tablet; Laptop; Smart Board - (tabelë e mençur). Autorizim nga Prodhuesi ose Distributori i Autorizuar Trajnimi i zyrtarëve të IT-se së shkollave për përdorim të tyre (50 orë).	Dëshmia 7 Katalogu për pajisjet e ofertuara. Dëshmia 8 Operatori ekonomik duhet të ofrojë katalogun në formë vizuale të platformës, vetëm për Fazën e parë (1). Deklaratë e nënshkruar dhe e vulosur nga OE se ofron mirëmbajtjen dhe ofrimin e mbështetjes teknike 24h 7 e cila do të zgjasë një (1) vit pas pranimit dhe funksionalizimit të databazës.

Kriteri diskriminues: Kerkesa: 7

- Pajisjet e nevojshme për platformë Tablet; Laptop; Smart Board - (tabelë e mençur). Autorizim nga Prodhuesi ose Distributori i Autorizuar

Deklarata, Faktet dhe argumentet:
Ne si NTSH UNISOFT konsiderojmë që vendosja e këtij kriteri është diskriminues dhe i panevojshëm, ky kriter na diskriminon ne si OE dhe favorizon një OE.

Ky kriter duhet të largohet nga FDT dosja e tenderit, njoftimi për kontratë

Kërkojm nga P.SH. i OSHP që të nxjerr:

VENDIM

I. **APROVOHET,** si e bazuar Ankesa e NTSH UNISOFT (Arianit R. Bytyqi B.I.)

II. **ANULOHET** Vendimi i datës 17.06.2024 i AK KK Prizren dhe lënda të kthehet në Rivlerësim dhe ne si OE NTSH UNISOFT të shpërblehemi me kontratë

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Ne si OE : Arianit R. Bytyqi (N.T.SH. UNISOFT) kemi shpenzime të konsiderueshme në përgatitjen e dokumentacionit, ofertave dhe pjesëve tjera të cilat ndërlidhet me këtë procedurë të prokurimit. Dëmi reflekton në dëmin material dhe jo material e i cili shtrihet edhe në raport me LMD neni 136, 137 duke mos u kufizuar edhe në dëmtimin e imazhit dhe pasojave të tjera që në këtë fazë nuk janë në tërësi të konkretizuara.

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
- *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, dhe*
- *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*